

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8SH-2
H35

JORDAN
HAXHINIKOLLA

NË
MES
TË
NJERËZVE

DRAMË


85H-2
H. 35

JORDAN HAXHINIKOLLA

NË MES TË NJERËZVE

dramë

3 akte dhe 1 tablo



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

P E R S O N A Z H E T

VIKTORI	<i>mjek</i>
LUMTOJA	<i>mësuese, vullnetare</i>
BESNIKU	<i>mjek, vullnetar</i>
ZANA	<i>infermiere, kooperativiste</i>
VERA	<i>brigadiere dhe sekretare e organizatës bazë</i>
ISLAMI	<i>stallieri i kooperativës</i>
DRITA	<i>e re kooperativiste</i>
ZYLOJA	<i>kooperativist</i>
ARTANI	<i>i ri vullnetar</i>
AGRONI	<i>traktorist</i>
KUZHINIERJA	<i>kooperativiste</i>
QEMALI	<i>shoferi i kooperativës</i>

AKTI I PARË

Ambulancë e thjeshtë spitali në një kooperativë bujqësore të bashkuar. Një korridor me një stol për të sëmurët. Ambulanca ka dy dyer ballë për ballë, një shtrat vizite, një dollap, një dritare nga ku duket një pjesë e fshatit. Në ambulance nuk ka njeri. Pas pak hyjnë në skenë Zana dhe kuzhinierja:

ZANA — Pasnesër të takon ta mjekosh plagën.

KUZHINIERJA — Të falmnderit, moj bijë. Ika unë tani se më pret kuzhina. (Niset.)

ZANA — Na gatuaj ndonjë gjë të mirë sot për drekë.

KUZHINIERJA — Hiç mos u bëj merak. (Del. Zana merret me punë, pastaj shkon prapa paravanit. Në këtë kohë hyjnë në korridor Drita me Viktorin).

DRITA — Ja, ky është spitali. (I bie derës. Nuk përgjigjet njeri, e hap derën dhe nuk e sheh Zanën). S'paska njeri. Doktor, unë po iki.., Ju rrini këtu në stol.

VIKTORI — Ju falemi nderit. (Hyn Agroni i veshur me pizhame.)

DRITA — Agron, si je sot?

AGRONI — Më mirë. Nuk kam më temperaturë.

DRITA — (Viktorit.) Njihuni... I fejuari im. (Viktori me Agronin shtrëngojnë duart. Drita me Agronin bisedojnë pak caste pa zë).

AGRONI — Do të ikësh?

DRITA — Do të nisem për në fshatin Drizë. (Viktorit). Ditën e mirë, doktor.

VIKTORI — Ditën e mirë!

AGRONI — Po të shoqëroj deri tek dera. (*Dalin të zënë për dore. Zana kalon nga ambulanca në korridor.*)

ZANA — Po ti, shok, mos je i sëmurë?

VIKTORI — Jo... jo... nuk kam asgjë.

ZANA — Kujtova se mos...

VIKTORI — Kërkoj doktor Besnikun. A është këtu?

ZANA — Tani është duke bërë vizitën e të sëmu-
rëve dhe kur viziton nuk do që ta shqetësojnë.

VIKTORI — Domethënë se është këtu?

ZANA — Po.

VIKTORI — Do ta pres, sa të mbarojë vizitën. (*Zana hyn në ambulance, merret me punë, por i kuj-
tohet diçka dhe del përsëri në korridor.*)

ZANA — Po ti kush je?

VIKTORI — Jam transferuar nga Tirana për të punuar
në spitalin tuaj.

ZANA — A? Ti je mjeku që?...

VIKTORI — Po!

ZANA — Ne kemi kohë që të presim. Na tha doktori
që do të vijë një mjek nga Tirana... Por urdhëro
brenda, doktor.... ma jep valixhen... (*Hyjnë
në ambulance. Zana vendos valixhen prapa pa-
ravanit.*)

VIKTORI — (*Ulet dhe i hedh një vështrim ambulance.*)

ZANA — Do ta kalosh mirë këtu!

VIKTORI — (*Nëpër dhëmbë*). Sigurisht!

ZANA — The gjë?

VIKTORI — Jo... jo... Jam ca i lodhur nga rruga.

ZANA — Dukesh... Por ulu (*I aftron karrigen.*)

VIKTORI — Të falem nderit!

ZANA — Në spitalin e Tiranës, ku ke punuar, doemos
është ndryshe. Atje... ke pasur të bësh me shumë
të sëmurë... Por dhe ne këtu, të të them të
drejtën, kemi goxha punë. Veç të sëmurëve ko-
hën më të madhe na e ha profilaksia: pastërtia,
vaksinimet, kontrolllet shëndetësore... Por ama kemi
një kolektiv të mirë... Nejse, kur t'i njoftohesh do
të bindesh vetë...

VIKTORI — Patjetër!

ZANA — Tani që erdhe dhe ti, doktor Besniku do
ketë më lehtë.

VIKTORI — Sigurisht!

ZANA — Me Besnikun do ta kalosh mirë... Këtu lenë
kokën për të...

VIKTORI — Ashtu??

ZANA — Ama duhet të dish një gjë: besimin dhe res-
pektin e njerëzve e ka fituar me mund e me
djersë... Askush nuk të nderon sot po nuk pu-
nove. Apo jo?

VIKTORI — As topi nuk e lot!

ZANA — Jemi kooperativë e zmadhuar. Janë dhjetë
fshatra që presin ndihmë nga ne.

VIKTORI — Sa? Dhjetë fshatra??

ZANA — Po.

VIKTORI — Telefon a keni këtu?

ZANA — Kemi, si nuk kemi... Ja tek është...

VIKTORI — Të falem nderit.

ZANA — Siç duket nuk paske qenë ndonjëherë në
fshat...

VIKTORI — Po me Tiranën a mund të flasësh?

ZANA — Po si jo? Me çdo vend mund të lidhesh.

VIKTORI — (Del për të marrë telefonin. Zana e
ndjek me sy, pak e habitur).

ZANA — Sigurisht... Patjetër... Ashtu... As / topi
nuk e lot... S'po marr vesh gjë. Mos ndoshta
ë ka dhe nga lodhja!

VIKTORI — (Nga jashtë.) Alo, shoqe, Tiranën desha.
A ka mundësi të më lidhësh. Mirë... do të të
marr më vonë: (Hyn Lumtoja, troket nē derë
dhe futet brenda nē ambulancë.).

LUMTOJA — Mirëdita, Zana!

ZANA — Mirë se vjen, shoqja mësuese!

LUMTOJA — (E shqetësuar). Si është Bardha sot,
moj Zana?

ZANA — Si të të them.

LUMTOJA — Më thanë që është rënduar.

ZANA — Po. Lumto.

LUMTOJA — Qe shëndosh e mirë. As unë nuk e kup-
toj se si u sëmur ashtu menjëherë. Desha të pyes
Besnikun se si do t'i vejë filli asaj vajze. (Hyn
Besniku me stetoskopin nē qafë.).

ZANA — Ja tek erdhi.

LUMTOJA — Mirëdita, doktor!

BESNIKU — Tungjatjeta!

LUMTOJA — Erdha të pyes për nxënësen time.

BESNIKU — Një minut, të lutem! (Shkruan diçka nē
kartelë. Ia tregon Zanës dhe diçka bisedojnë pa
zë. Zana merret me punë.). Tani urdhëro!

LUMTOJA — Si është puna e Bardhës?

BESNIKU — Po... Të them të drejtën me gjithë përp-
pjekjet që po bëjmë për ta shëruar atë vajzë, gjen-
dja e saj nuk po më pëlqen.

LUMTOJA — Si shpjegohet? Mos ka ndonjë gjë me
rrezik? Mua mund të ma thuash... Besoj se nuk
më fsheh gjë.

BESNIKU — As unë nuk e di se si ndodhi. Kishte

marrë pér mirë, kur një ditë vajza u keqësua...
Nejse... Kam besim se do ta shërojmë.

LUMTOJA — Të lumtë goja!

BESNIKU — Pér këtë do të na ndihmosh dhe ti,
Lumto.

LUMTOJA — Unë?... Por unë nuk jam mjekë.

BESNIKU — Por je mësuesja e saj, ama. Sa herë që
vjen në dhomën e Bardhës, asaj i shkëlqejnë
sytë nga gëzimi. Kjo do të thotë që ardhjen tënde
vogëlushja e pret me interesim dhe çdo gjë,
dhembja, temperatura sikur i lehtësohen.

LUMTOJA — A ka mundësi ta shoh pak?

BESNIKU — Po të shoqëroj.

LUMTOJA — Të falem nderit!

BESNIKU — Dalim? (*Dalin. Pas pak Lumtoja kthehet
në korridor*)

LUMTOJA — Sa shumë që përvëlonë! Sa ishte dobë-
suar! Ma këputi shpirtin tek e shihja të zbetë e
të pafuqishme... Unë e kam parasysh Bardhën
të shkathët, të gjallë, çamarroken e klasës. (*Hyn
Besniku.*)

BESNIKU — Hë?

LUMTOJA — Si do të bëhet me të, Besnik?

BESNIKU — Do të përpinqem ta shëroj. Disa sëmundje
kështu janë: kanë periudha keqësimi, nuk largo-
hen lehtë e lehtë... Më fal një minutë, (*Hyn në
ambulance,*)

VIKTORI — Doktor Besniku?

BESNIKU — Po ... urdhëro?

VIKTORI — Unë jam mjeku që u transferova në spi-
talin tuaj.

BESNIKU — Vërtet? Më fal, të lutem të më falësh.
Unë isha pak i hutuar, po përse nuk më folët?
Je doktor Viktori, apo jo?

VIKTORI — Po, unë jam... Po e shoh që je shumë i zënë. Pres ...

BESNIKU — Ulu, të lutem. Po si je? A u lodhe ndopak nga udhëtimi?

VIKTORI — Që nga stacioni deri këtu erdha në këmbë.

BESNIKU — S'ka gjë... Besoj se je kënaqur me panoramën e fshatit tonë. Ajo copë rrugë është pjesa më e bukur. E di? Unë shpeshherë e bëj në këmbë dhe të të them të drejtën kënaqem. Fshati ka romantikën e vet. Fushë që zverdhon, kodra me pemë, ajër të pastër, lumi që ndrit si shirit i argjendtë, njerëz që punojnë plot gjëzim në arat pa mbanim...

VIKTORI — Fshat i bukur me gjithë mend... I sistemuar,... por ama u lodha ca.

BESNIKU — Do të mësohesh edhe me të ecur. Të ecu-rit të bën mirë,... të mban në formë. (*Ndërron bisedë.*) Do të të njoh me shoqen Lumto, mësuese në shkollën e fshatit (*Del në korridor, thérret Lumton dhe hyjnë në ambulancë. Lumtoja dhe Viktori shihen gjatë. Ai ia shtrëngon dorën me të dy duart.*) Doktori ka ardhur në fshat tek ne dhe do të punojë në spitalin tonë.

VIKTORI — Gëzohem!

BESNIKU — Ke qenë tjetër herë në këtë fshat?

VIKTORI — Jo!

BESNIKU — Unë dhe Lumtoja jemi qytetarë. Po të them të drejtën nuk e ndiejmë veten keq këtu. Kooperativistët janë njerëz bujarë, të singertë e të respektueshëm... Ke për t'i njohur dhe do të bindesh.

VIKTORI — S'kam asnje dyshim... Ndoshta është kështu si thua.

BESNIKU — Jo ndoshta, por kështu është.

LUMTOJA — Kjo është më se e vërtetë!

(Besnikut) Unë po iki, ju keni punët tuaja...
Ditën e mirë!

BESNIKU — Mirupafshim!

VIKTORI — Ditën e mirë! (*Lumtoja del*)

BESNIKU — Si e kam profesor Petritin, si është me shëndet?

VIKTORI — Edhe ai u transferua në spitalin e një rrithi.

BESNIKU — Ashtu? Është mjek i zoti... Studjon mjaft. Njeriu gjithmonë ka diçka për të mësuar. Jeta midis njerëzve është një shkollë e madhe, është laboratori më i madh, do të thoshja...

VIKTORI — E çfarë do të mësojë tani profesor Petriti, atje ku ka vajtur, ë! Çfarë? Duhet të jemi objektivë. Për mendimin tím ai mund të japë vetëm atje ku punonte më parë.

BESNIKU — Më vjen keq, po nuk jam dakord me mendimin tënd. Edhe njerëzit në bazë kanë nevojë për specialistë, për njerëz të aftë. Prandaj mjekët duhet të venë sa më afér njerëzve.

VIKTORI — (*I zënë ngushtë.*) Nuk desha të thosha atë... E kisha fjalën tek fakti se ai është i pazëvendësueshëm.

BESNIKU — Sot nuk ka më njerëz të pazëvendësueshëm... Kur erdha këtu gjuhëgjatët filluan të pëshpërisin. «Po e mbushi motin doktori këtu, ne shpohemi në hundë»... Unë i mbusha tre vjet që banoj e punoj këtu në fshat, po llafazanët nuk u shpuan në hundë... (*Qesh*).

VIKTORI — Po të doni e lëmë këtë bisedë. A kanë menduar për mua se ku do të banoj?

BESNIKU — Mos u shqetëso. Kryesia e kooperativës i ka marrë të gjitha masat, të ka caktuar një dhomë.

VIKTORI — Ku?

BESNIKU — Diku aty pranë shkollës.

VIKTORI — Po për të ngrënë?

BESNIKU — Në mensë!

VIKTORI — A hahet mirë?

BESNIKU — Si hanë të gjithë.

VIKTORI — Dhoma a ka krevat?

BESNIKU — Këtu të gjithë flenë nëpër krevate me sustë.

VIKTORI — Më fal që pyes, por jäm ca merakli. S'ke ç'i bën, jam mësuar këshfu ... Mos ma merr për të keq.

BESNIKU — Mos u bëj merak, të gjitha do të rregullohen... Me të vërtetë nuk ke qenë ndonjëherë në fshat?

VIKTORI — Kam qenë si jo... por për pak ditë..., Bile origjinën e kam nga fshati.

BESNIKU — Fshati ka ecur përpara. Do të *dalim* së bashku, do të njoh me shokët e kryesisë së kooperativës. Do të të çoj edhe në dhomën ku do të banosh se *ndoshta*... Po më parë vendosu këtu. Po pate nevojë edhe mund të qetëso-hesh.

VIKTORI — S'e ndiej të nevojshme.

BESNIKU — Si të duash. Unë po shoh të sëmurët, ndërsa ju çlodhumi. (*Dalin. Pas pak hyn Zana dhe mbas saj Zyloja.*).

ZYLOJA — Moj Zana.

ZANA — Hë, xha Zylo.

ZYLOJA — Si është Bardha?

ZANA — Po... diçka më mirë.

ZYLOJA — Çdo të thuash me këtë «diçka më mirë»?

ZANA — Po ja...

ZYLOJA — Të vete ca ta shikoj.

ZANA — Nuk mund të të le, xha Zylo. Mos të të vijë keq. E kam të ndaluar.

ZYLOJA — Po unë e kam evlat, moj. Dua ta shikoj.

Si u bëkërka kjo punë kështu, xhanëm? Një e dy vetëm një fjalë ke në gojë: Nuk lejohet!

Eshtë e ndaluar!

VIKTORI — (*Duket tek dera.*) — Ç'keni?... ç'keni?

Ç'është kjo zhurmë. Ka të sëmurë këtu ... Ku jemi, në han?

ZANA — Do që të hyjë se ka vajzën të shtruar, doktor.

ZYLOJA — O shoku doktor.

VIKTORI — E mora vesh... po ule zërin. Nuk je në fushë këtu. (*Zanës.*) Edhe ti deri sa nuk ka njerëz lere 5 minuta, dreqi ta hajë... (*Del.*)

ZYLOJA — E dëgjove?

ZANA — Këto janë rregulla që duhen respektuar. Unë s'mund t'i thyej ato.

ZYLOJA — Atje ku doni ju i thyni që ç'ke me të.

ZANA — Më kupto drejt, xha Zylo, nuk mundem.

ZYLOJA — (*I inatosur.*) Unë do të hyj!

ZANA — Xha Zylo, nuk bën kështu. Pastaj ti po më pengon (*Hyn Lumtoja*).

LUMTOJA — (*Sheh përqark. Nën zë.*) Ku vajti... Viktori?

ZANA — Brenda. (*Xha Zyloja matet të hyjë tek të sëmurët.*) Jo andej, xha Zylo.

ZYLOJA — Moj Lumto! Thuaj edhe ti të më lërë.

LUMTOJA — Do t'i them mos të të lërë.

ZANA — E dëgjove? (Del.)

LUMTOJA — Ç'ke? Pse je i inatosur?

ZYLOJA — (Ulet tek stoli.) Po ja, moj shoqja më-suese, nuk më le të futem pak në dhomën e Bardhës.

LUMTOJA — Prandaj tū kërkova! Vajza edhe në shtëpi. Vajza nuk duhet shqetësuar. Pak më parë isha tek ajo.

ZYLOJA — Vërtet? Si është sot?

LUMTOJA — Besniku po ia bën të gjitha mjekimet.

ZYLOJA — Është pak më mirë?

LUMTOJA — (Eviton vështrimin.) Do të bëhet edhe më mirë, për këtë mos ki asnje dyshim, xha Zylo.

ZYLOJA — Si, moj bijë, nuk kam besim! Kur e ke parë ti, njëlloj është sikur e kam parë vetë.

LUMTOJA — Eja tani të shkojmë e ta lëmë Bardhën të flerë. Pastaj... edhe Zana ka punë me të së-murët. Mirupafshim, Zana!

ZYLOJA — (I penduar hap derën dhe futet në ambulance) Më fal, moj bijë, se ndoshta e teprava ca, por kur ka keq njeriu edhe e shkel ndonjëherë. Mos ia vërë re plakut.

ZANA — Mirë ardhshi (Del Zyloja dhe Lumtoja. Hyn Viktori dhe sheh Lumton në prag të derës).

VIKTORI — Lumto! (Ajo s'e ka dëgjuar dhe del).

ZANA — Të drejtë ka dhe ai... po...

VIKTORI — Çfarë po... Më mirë ta kishe lënë për një çast se sa na u bë gjithë ajo zhurmë, që shqetësoi gjithë të tjerët.

ZANA — Jo doktor.

VIKTORI — (I nxehur.) Mos më thuaj jo, por shih njeriun me cilin ke të bësh...

ZANA — Si njeriun?

VIKTORI — Fshatar, moj shoqja infermiere. Ku je këtu? Në qytet?... Kaq ia thotë. Prandaj shih e bëj dhe jo si puna e kalit të karrocës... (*Del për të marrë telefonin; dëgjohet zëri nga jashtë.*) Alo, alo! Shoqja centraliste, më jepni Tiranën. Kush jam? Një mijek i ri këtu në spitalin e kooperativës ... Ju falemnderit! (*Pauzë*) Nuk ka njeri... Si është e mundur? Hajde ters, hajde... Nuk e kam me ju, jo. (*Lë telefonin.*)

ZANA — Familjen more?

VIKTORI — Familjen...

ZANA — Kaq shpejt të mori malli? Si duket s'je larguar ndonjëherë nga njerezit.

VIKTORI — Po dhe s'jam larguar...

ZANA — Mos u mërzit, me ne do ta kalosh mirë. Kot e ke marrë pa qejf ardhjen në spitalin tonë.

VIKTORI — Nga e more këtë të dhënë ti, moj shoqe? (*Nervoz.*) Të lutem shumë vazhdo punën tënde aty ku je dhe mos më bëj moral se kam disa muaj që e dëgjoj këtë muzikë.

ZANA — Dëgjo doktor... megjithëse nuk doja t'ia fillonim kështu, po meqë e nise vetë shumë keq... mos më ndërpri. Fshatarët ne i kemi të edukuar, të mirë, pavarësisht se ai bërtiti,... unë i jap të drejtë se kishte hall... E para, s'ke të drejtë të na quash kështu dhe e dyta mos na bëj të shkelim rregullat...

VIKTORI — (*E sheh me vërejtje.*) Të ra hunda ty... Leri fjalët e shiko punën aty... atë bëj ti.

ZANA — Më duket se po zemërohesh kot.

ISLAMI — (*Nga jashtë.*) Hiç mos u bëj merak, o Zylo, e kalon ajo se është e re... (*Hyn*) Hë, moj çu-

pë... Zyloja po ma qante hallin, i shkreti, për
të bijën... Kaq sëmurë e ka?...

ZANA — E ka ca... Prind, xha Islam.

ISLAMI — Fjalë plaku fole.

ZANA — Ç'e mirë të solli këndeje?

ISLAMI — Pleqëria, moj bijë. Pleqëria më solli. (*Kollitet.*) Janë habere këto. Besniku ku qenka kështu?

ZANA — Ka dalë, po shpejt do të kthehet. Po të duash prite...

ISLAMI — (*Viktorit.*) Edhe ti, o shok, i sëmurë je?

VIKTORI — (*Bën sikur nuk e dëgjon.*)

ISLAMI — Na, moj çupë, nga ka ardhur ky shoku?

ZANA — Nga Tirana. Është mjek.

ISLAMI — (*I habitur.*) Ç'thua moj?! Doktor qenka?
Po ç'ka që nuk flet? (*Ngadalë.*) Më duket se
nuk e kuptoka shqipen. E vritka lart.

ZANA — (*Kafshon buzën dhe i zë krahun Islamit,
Viktorit.*) Doktor, xha Islami është i sëmurë
dhe kërkon të vizitohet.

VIKTORI — (*Pa kthyer kokën.*) Nga se ankohet?

ISLAMI — (*I nxehur.*) Po ti kthehu një herë këndeje,
o lum miku, dhe pastaj pyet se ç'kam... Ti nuk
po bëhesh imbarë të më hedhësh as sytë, o derë-
bardhë.

VIKTORI — (*I zënë ngushtë.*) Çfarë të dhëmb!

ISLAMI — (*Ulet tek krevati i vizitës, shkopshitet dhe
tregon një pjesë të trupit.*) Ja këtu, sikur më
shpon njeri me thikë.

VIKTORI — (*E viziton pa kujdes.*) Me siguri je ftetur
ca. (*Shkruan recetë.*) Pak aspirinë, çaj të
ngrohët dhe një fërkim me kamfora.

ISLAMI — (*Duke rregulluar teshat.*) Vesh të mprehtë
paske! Vizitë më bëre! Hë më të lumtë!

VIKTORI — Nuk kam qejf tē bëj shaka.

ISLAMI — As unë nuk e kam atë nge tani. Kam ardhur pér hall. Por e shoh se nuk e bëkërke qejfin qeder. (*Viktori i ka zgjatur recetën Islamit, por ai nuk e merr. Zanës.*), Mirupafshim, bijë, do tē vij kur tē jetë doktor Besniku, ai na i qan hallet neve. (*Del dhe kthehet prapë*). Më fal se tē prisha qetësinë! (*Del.*)

VIKTORI — Ç'është ky? Ç'punë bën?

ZANA — Është stallieri i kooperativës.

VIKTORI — Pse u zemërua ashtu? Si i erdhi?

ZANA — Nuk vepruat mirë, doktor. Nuk u sollët...

Mos e shih ashtu. Ai është një nga njerëzit më punëtorë këtu tek ne... më i respektuari.

VIKTORI — Edhe ti, qepe më mirë.

ZANA — Unë?!?

VIKTORI — Ti... po kush, unë?

ZANA — Po përsë?

BESNIKU — (*Hyn në korridor, dëgjon grindje dhe tund kokën.*)

VIKTORI — Unë këtu nuk jam hu gardhi... Leri fjalët... Doktor Besniku jam unë tani këtu.

ZANA — Unë e kuptoj ...

VIKTORI — Po e shoh... po e shoh! E lemë këtë bisedë tani! (*Hyn Besniku.*)

ZANA — Hë, doktor? Si ishte?

BESNIKU — Çka...


ZANA — Nuk ka asnjë ndryshim?

BESNIKU — Është shpejt akoma... Po çfarë ka ndodhur?

VIKTORI — (*Nuk përgjigjet*)

BESNIKU — Zana, çfarë keni.

ZANA — Asgjë! (*Del në korridor e zemëruar.*)



BESNIKU — Shoku Viktor, kur hyra në korridor dëgjova disa fjalë të thëna me një ton që nuk lejohet... Këtë ta them si shok...

VIKTORI — Ma bëri borxh. Kjo infermiere është e p-
edukuar.

BESNIKU — Gabohesh. Unë kam tre vjet që punoj me të dhe e njoh. Mund të them se ajo është punëtore, e ndërgjegjshme dhe i ka shoqet e rralla... Këtë e them me përgjegjësi.

VIKTORI — Mund të jetë punëtorë, po kjo s'do të thotë se nuk mund të jetë dhe një llafazane e keqe. (*Hyn Zana e cila ka dëgjuar dialogun.*)

BESNIKU — Zana, shko në detyrë...

ZANA — (*E përbajtur.*) Po... doktor... (Del):

BESNIKU — Mendoj se për ju është akoma shpejt të jepni gjykime për njerëzit.

VIKTORI — Ndoshfa... Por muhatja dhe çfarë ndodhi flasin ndryshe...

BESNIKU — U njohët me të sëmurët.

VIKTORI — Jo akoma... Sa për sot mjafton që njoha dhomën ku do të fle, vendin ku do të ha dhe.,,

BESNIKU — Dhe vendin ku do të punosh.

VIKTORI — Po... Edhe nga puna do të filloj. (*Vesh bluzën me nervozizëm.*)

(*Dëgjohet zhurma e traktorit. Nga aneksi hyn Agroni i veshur me pizhame.*)

AGRONI — Me leje, shoku Besnik?

BESNIKU — Urdhëro! Ç'pate që u ngrite nga krevati?

AGRONI — Po ja... kisha një lutje.

BESNIKU — Po thuaje, mor Agron. Thuaje ta dëgjojmë bashkë me doktor Viktorin.

AGRONI — Siç e dini umë jam traktorist... Po rrija në krevat, kur dëgjova zhurmën e traktorit që po punon në arën këtu pranë. E nget ndihmësi im...

Por ajo zhurmë nuk po më pëlqen fare, me siguri që do të ketë ndonjë defekt në valvolat... Ka rrezik të prishet motori...

BESNIKU — E dëgjon, Viktor. Edhe Agroni në njëfarë mënyrë është mjek. Me të dëgjuar rrahjet e motorit e kupton defektin. Në gjuhën tonë kjo do të thotë: i vuri diagnozën.

AGRONI — E po, kam kaq vjet që merrem me traktorë. Ia njoh dhëmbë e dhëmballë motorit.

BESNIKU — Po mirë ... çfarë këndon të bësh ti, Agron?

AGRONI — T'i vi në ndihmë shokut, sepse ai është i ri e pa përvojë. Dua vetëm një orë leje.

VIKTORI — Shko ore shtriu në krevat! Ka kush e bën atë punë!

BESNIKU — (*Ndërhyrja*) Viktor ka të drejtë... Dëgjo, Agron... Thuaji Zanës, që ta sjellë ndihmësin tënd këtu dhe ti shpjegoja defektin... Nuk bën që të dalësh jashtë, është ftohtë akoma.

AGRONI — (*Hesht një çast*) Të falemnderit! (Del.)

BESNIKU — Hë! Si e kupton ti këtë, të lutem? Megjithëse është i sëmurë, ai prapë do të ndihmojë shokun. Duket që i hanë duart për pumë atij njeriu.

VIKTORI — Pse ma thua këtë?

BESNIKU — Sepse ty të kam këtu... pranë. Pastaj gjithmonë kemi nevojë të mësojmë. (*Hyn Zana*).

ZANA — (*Besnikut*) Doktor, s'paskeni i kur?

BESNIKU — Jo Zana, sonte nuk do të largohem fare... Bardha ...

ZANA — Sot je lodhur.

BESNIKU — Është e domosdoshme... A bisedova gjë me Agronin?

ZANA — Tani do të dërgoj të thërrasin ndihmëstraktoristin. (Del.)

BESNIKU — Po shkoj tē shoh pak një tē sémurë dhe do tē kthehem (*Del.*)

VIKTORI — (*Bie zilja e telefonit.*) Mama, ti je... Jam Viktori... U lodha ca, por më nē fund mbërrita... Tani e pati kjo punë. Çfarë do tē bëj, the? Atë punë që bën një mjek fshati nē një spital tē vogël. (*Pauzë.*) Si? Punë shkencore? E, moj mama! Po unë atë hall kisha, që nuk doja tē vija këtu... Por as ti nuk më kuptove? Mirë, mama, mirë, unë do tē vi dhe një herë, ti lëviz gurët aty. Si?... E mirë, mirë, s'ke faj ti, fajin e kam unë që tē thashë. (*Ul telefonin.*) Nuk tē vjen tē pëlcasësh... Daulle më është bërë koka... Po kësaj si t'i thuash?! (*Hyn Lumtoja.*)

LUMTOJA — Kujt?...

VIKTORI — Si kujt?

LUMTOJA — Me kë po flisje?

VIKTORI — Ah! Po... se ç'mu kujtua... (*Hyn Besniku.*)

BESNIKU — Filluat tē njiheni? (*Lumtoja e Viktori shohin njëri-tjetrin*) Lumto, tregoi për fshatin, tregoi... Ne e kemi këtë tē drejtë, ndërsa ti duhet tē na dëgjosh... Më vonë pasi tē kesh bërë një farë kohe këtu, do tē kesh radhën t'u flasësh për fshatin atyre që do tē vijnë. (*Qeshin.*)

LUMTOJA — Si është Bardha?

BESNIKU — Tek ajo isha!

LUMTOJA — Hë?

BESNIKU — Po...

VIKTORI — Kur është rëndë, pse e mbajmë këtu? Dërgojeni nē spitalin e rrëthit.

BESNIKU — Ne duhet ta shërojmë atë vajzë, kupton?

VIKTORI — Me se! Po sikur...

BESNIKU — Çfarë sikur?...

VIKTORI — E gjithë përgjegjësia do të bjerë mbi më.
Hajde pastaj dëgjo fjalë.

BESNIKU — Lumto, shko ti, shko. (*Lumtoja sheh Viktorin dhe del.*) Ne nuk duhet të kemi frikë nga përgjegjësia.

VIKTORI — Ju jeni mjaft i lodhur, prandaj shkoni në shtëpi e qetësuhuni. Unë po rri në spital, mos kini asnjë merak.

BESNIKU — Ne jemi kolegë dhe s'ka pse të kem merak
... Po, sidoqoftë, unë kam kohë që merrem me të
dhe ia di ... Nuk ... (*Zilja e telefonit. Besniku merr receptorin.*) Urdhëroni! Spitali, Besniku jam
... Ju jeni, shoku Rexhep? Patjetër, mos u bëni
merak. Që tani bile, mos u shqetësoni. (*Vendos receptorin.*)

VIKTORI — Kush ishte?

BESNIKU — Shoku Rexhep, kryetari i këshillit.

VIKTORI — Ç'ka ngjarë?

BESNIKU — Në fshatin Drizë është një e sëmurë që duhet ta vizitojmë.

VIKTORI — Sa mban fshati që këtu?

BESNIKU — Një orë më këmbë ... Vetëm se është ca malore. (*Pregatitet menjëherë.*)

VIKTORI — Por a nuk pret puna deri nesër? Po erret.
Fshat është. Rrugë pa rrugë (*Besniku e shikon drejt në sy.*).

BESNIKU — Nuk dihet se ç'rast është. (*Merr çantën.*)
Atëherë juve do të prisni derisa të kthehem unë,
Viktor.

VIKTORI — Sigurisht! ...

BESNIKU — (*Thërrret.*) Zana!

ZANA — (*Nga jashtë.*) Urdhëro, doktor! (*Hyn.*)

BESNIKU — Zana, unë po nisem ... këtu ke Viktorin
... (*Viktorit.*) Doktor, kujdes Bardhën dhe për

ndonjë urgjencë tjetër ... Mirupafshim, nuk besoj tē vonohem. (*Del*).

ZANA — Sa tē mbaroj injeksionet, erdha.

VIKTORI — Tē pres. (*I vē dorēn mbi sup. Zana e sheh dhe del, pas pak hyn Lumtoja nga dhoma e Bar-dhēs.*).

LUMTOJA — Ku ēshtë Besniku?

VIKTORI — U nis pēr një urgjencë. Pērse e kérkon?

LUMTOJA — Jo ... Jo ... s'ka asgjë ... Tani Bardha ēshtë qetësuar. (*Niset tē dalē*.)

VIKTORI — Lumto!

LUMTOJA — Fol!

VIKTORI — Lumto, kot që nuk u bëre mjeke.

LUMTOJA — (*Qesh.*) Asnjëherë nuk më ka shkuar ndër mend që tē bëhem mjeke. Më ka pëlqyer tē jem mësuese, tē mësoj fëmijët! Kjo më jep kënaqësi.

VIKTORI — Bluza e bardhë tē paska hije.

LUMTOJA — Edhe detyra e mësuesit ēshtë po aq humanitare sa dhe ajo e mjekut.

VIKTORI — Nuk thashë se jo... por si tē tē them.

LUMTOJA — Nuk jam dakord me mendimin tēnd.

VIKTORI — Ke ngekur gjithmonë po ajo që ke qenë.

LUMTOJA — Ndërsa unë do tē thosha se ti je po ai që ke qenë dikur.

VIKTORI — Lumto!

LUMTOJA — Fol!

VIKTORI — Mos u nxito tē më japësh përgjigje menjëherë.

LUMTOJA — Po tē dëgjoj.

VIKTORI — Besoj se këtë radhë do tē më dëgjosh deri në fund... Kam shpresë se së shpejti mund tē kthehem përsëri në qytet... Ti si mendon?

LUMTOJA — Ti e di mendimin tim ... Pēr këtë paske ardhur? (*Niset tē ikē*).

VIKTORI — Zbatova urdhërin... Prit! Vetëm një gjë
duhet të dish: në këtë fshat kërkova të vija, sepse
ishe ti këtu.

LUMTOJA — Shumë keq që paske ardhur me këto
mendime.

VIKTORI — Nuk paske ndryshuar aspak!

LUMTOJA — As ti!

VIKTORI — (*I zemëruar.*) Filloi prapë kapitulli i parë.
(*Sheh orën.*) Nejse ... Do të desha të vazhdonim
bisedën. Por dua të mjinhem me të sëmurët... Do të
bisedojmë prapë. (*Del.*)

LUMTOJA — Ah! Viktor, Viktor. Me gjithëse u bë kaq
kohë që s'jemi parë... ti s'paske ndryshuar fare.

AKTI I DYTE

Skena paraqet 3-4 pemë. Në sfond duken arat e mbjella me grurë, një varg kodrash, shtëpi fshati të reja, aty këtu dhe ndonjë shtëpi me dy kate. Në të majtë një urë e vogël. Në të djathtë një stendë, ku vendosen fletërrufe. Cicërima zogjsh. Në skenë është Artani duke lyer me furçë pemën e fundit me gëlqere.

ARTANI — Ja dhe pema e fundit mbaroi. (*Hipën mbi urën e vogël*) Ej, ju andej, si shkoni?

DRITA — (*Nga jashtë*.) Mbaruam, Artan, mbaruam.

ZANA — (*Nga jashtë, nga krahu tjetër i skenës*.) Edhe ne mbaruam. (*Hyjnë në skenë, duke fshirë teshat, me kova plastmasi, furçe, Drita, Zana, kuzhinierja, Zyloja, Qemali*).

ARTANI — Unë sot mund të them se fshati ynë nuk ndryshon shumë nga qyteti... Po nesër?

ZANA — Nesër do të jetë me siguri si qyteti.

KUZHINIERJA — Ashtu, moj të keqen nëna, ashtu... Ah, sikur të isha dhe ca më e re...

ZANA — (*I afrohet*.) Dhe buzë lumit nën hijen e pemëve me ...

KUZHINIERJA — Me Hasanin tim kapur për krah...
(*Qeshin tē gjithë.*)

QEMALI — Me xha Islamin ...

KUZHINIERJA — (E kercën.) U më marrç tē kegen!
(*Qeshin. Hyn Lumtoja.*)

LUMTOJA — Ç'është ky gaz?

ZYLOJA — (Me shaka.) Kërkon tē na martohet dhe një
herë kuzhnierja... (*Qeshin.*)

KUZHINIERJA — Mos ma qaj hallin mua, o Zylo...
Apo i mat njerëzit me kutin tënd...

ARTANI — Të vuri përpara, o xha Zylo... Mos u
dorëzo.

KUZHINIERJA — E çfarë tē thotë?... Atë e tregon
shkopi që mban në dorë. (*Zyloja ngre shkopin në
ajër, gjoja për ta goditur. Zana ia kap.*)

ZANA — Po si, po si ... Kur nuk ia del dot me fjalë,
atëherë e ngre shkopin përpjetë.

KUZHINIERJA — Epo, burrë zamani.

ZYLOJA — (Kërkon tē flasë)

ZANA — Rri mos fol, xha Zylo se e shkele.

ZYLOJA — Po kur ka keq tjetri...

LUMTOJA — Rregulli është rregull. Ti këtë e di. Ja,
për shembull grupi ynë i kreu detyrat nën drejtimin
tënd dhe të dëgjoi deri në fund. Apo jo?

ZYLOJA — Pooo! ... Dhe më nderuat ... Bukur i keni
lyer. (*Vështron pemët.*)

LUMTOJA — Prandaj rregullat që janë vendosur nië spi-
tal, duhet t'i respektojmë që të gjithë.

ZYLOJA — Po ti e pe, moj shoqja mësuese, se unë i
kërkova ndjesë Zamës, (*Zamës.*) Apo jo, moj bijë?

ZANA — Po, xha Zylo.

KUZHINIERJA — Mos kërko, po të duash.

ZYLOJA — Fillove prapë ti ... M'u bë tamam si Drita

e Myrtos, sepse ajo më ngacmon e më është ngjitur tamam si rrodhe... (*Qeshin*)

DRITA — (*I afrohet.*) Xha Zylo, ja tek jam.

ZYLOJA — A shejtane, ti ... Nejse, t'i lëmë shakatë ...

Juve u lumshin duart, që të gjithëve, më kënaqët e më nderuat. Ama dhe unë fjalët më të mira do të them për ju.

LUMTOJA — Xha Zylo, unë të raportoj se nxënësit e klasës sime i mbaruan së lyeri të gjitha pemët.

ZYLOJA — Pëllumbat e xha Zylos ... Si gjithmonë fëmijët tanë i kemi në ballë. (*Hyn Islami me një fletërrufe të madhe në dorë dhe shkon e vendos në stendë*).

ARTANI — Ç'e ke këtë, o xha Islam?

ISLAMI — Po ju këndojeni një herë ... Ja tek e keni. (*Ulet diku, nxjerr kutinë e duhanit dhe matet të dredhë një cigare*).

ARTANI — (*I afrohet stendës.*) Oh, e paska për doktorin!

KUZHINIERJA — Je në vete, ore Islam?! Por ne e kemi goxha doktor.

ISLAMI — Po ju lexojeni një herë. (*Të gjithë i afrohen stendës*).

LUMTOJA — E ka për Viktorin.

KUZHINIERJA — Thashë se mos e kishte për doktor Besnikun.

ISLAMI — Vetëm po të më kishin rrjedhur trutë, do të bëja një gjë të tillë.

ZYLOJA — Iu qepe, që iu qepe atij doktori.

ISLAMI — Unë kam shkruar atë që ndjej dhe dua që ta ndihmoj.

LUMTOJA — Më duket se xha Islami bëri mirë që i vuri fletërrufe. Ai ka shumë të drejtë kur thotë se kërkon ta ndihmojë.

ISLAMI — (*I nxehur.*) E po më thoni ju, ku e kemi Viktorin? Ku është ai? Dhe aq më tepër sot që është ditë aksioni.

ARTANI — Ja se çfarë thotë në fletërrufe: «Mjek kemi dhe mjek s'kemi. Kokën e ka në qytet, ndërsa këmbët këtu në fshat. Nuk i pret mirë njerëzit në vizitë, për shembull mua as që begenisi të më vizitojë mirë. Mendoj se është më mirë t'ia themi gjërat troç, sepse kështu e ndihmojmë dhe nuk ia lëmë të metat që të trashen si shualli i këmbës. Unë kështu mendoj, nëse e kam gabim shokët le të më kritikojnë.

ZANA — Të lumtë, xha Islam. Ti e ke shumë drejt ... Pastaj, këtu nuk është fjala vetëm për Viktorin, por dhe ne të tjerët kemi se çfarë të shikojmë në vreten tonë ...

LUMTOJA — Mua më duket se xha Islami e ka vënë gishtin tamam në plagë. Edhe ne ia kemi thënë Viktorit, por ai me sa duket vazhdon më të tijën.
(Hyn Vera me një kovë e furçë dhe Besniku.)

VERA — Lumtoja ka të drejtë. Dhe ne që të gjithë me këtë gjuhë duhet të flasim... Po Viktorin ne duhet ta kemi më mesin tonë, sepse ai është njëriu ynë ... Ne duam që dhe ai të flasë me këtë gjuhë. **ISLAMI** — Pa më thoni: po këta nuk janë qytetarë: Besniku, Lumtoja, Artani? Këta nuk kanë prindër dhe familje?

VERA — Jo çdo njeri e kap dhe e kupton menjëhërë të renë, kryesore është që të gjithë me, që punojmë e jetojmë me Viktorin, duhet ta ndihmojmë që dhe ai ta kuptojë e të bëhet një luftëtar i denjë për rrugën tonë.
(Dëgjohet zhurma dhe sirena e trenit që kalon. Të gjithë përvënësin trenin me dorë).

ARTANI — Shoqja Vera, po shkoj në stacion të marr gazetat.

VERA — Mirë, Artan!

ARTANI — Ika. (Del).

VERA — Fluturoi.

KUZHINIERJA — Tani duhet të fluturojmë dhe ne, mua më pret kuzhina, kurse Islamin... (Niset.)

ISLAMI — Mua më pret stalla.

DRITA — Lumton e pret: pikë, pikë, pikë ...

KUZHINIERJA — (Kthehet nga rruga.) Ua! Ç'është kjo pikë, pikë, pikë. Moj thëngjill i mbuluar!

LUMTOJA — Ama Dritën dëgjon ti?

VERA — Nejse! Kur t'ia bëjë bam një ditë, do të na e thotë edhe ne ...

KUZHINIERJA — Kur të ma thuash mua, mos më hajde pa llokume në kuzhinë. (Qeshin.)

LUMTOJA — (Dritës.) Moj ti, ç'qe ky muhabet kështu?

DRITA — Ashtu kot ... Ika unë se më pret televizori.

LUMTOJA (Kurioze.) E ç'është ky televizor?

DRITA — Do ta marrësh vesh. (Del.)

BESNIKU — (Verës.) Si është kjo punë?

VERA — Hë, se ku ka zë, nuk është pa gjë.

BESNIKU — A, Lumto, Lumto...

LUMTOJA — Po jo, mor doktor Besniku ... Sikur nuk e njeh Dritën.

BESNIKU — Nejse! Në mos sot një ditë do t'ia bëjë bam... Ika se më presin në spital. (Kalon përpara fletërrufesë. Ndalet.) A, Viktor, Viktor!

LUMTOJA — Do ti bëjë mirë!

BESNIKU — Duhet ta ndihmojmë ...

NJË ZË NGA JASHTË — Lumto, a është aty shoqja Vera?

LUMTOJA — Këtu është.

ZËRI NGA JASHTË — I thoni pak se e kërkojnë!

VERA — Mua më falni, besoj se nuk do të vonohem.

(Lumtos.) Ti, Lumto, më prit ca se dua të bisedoj. (Del. Hyn Zyloja.)

BESNIKU — (Përpëra fletërrufesë.) Eh, mor Viktor!

ZYLOJA — Më duket sikur është fryrë ca!

LUMTOJA — Unë them se jo.

ZYLOJA — Unë sikur e njoha një çikë më mirë se më lidhi halli me të. Ai u gdhi bashkë me Besnikun. Këtë mund ta thotë dhe vetë doktori. (Tregon Besnikun.)

BESNIKU — Kjo është e vërtetë.

ZYLOJA — Edhe me mua është sjellë mirë. Vajzën më la ta shikoj.

BESNIKU — Këtë nuk duhej ta bënte.

LUMTOJA — Ne të dëgjuam të gjithë për detyrën që na ngarkove. Po të kishte bërë secili sipas kokës s'do të kishim bërë as gjysmën e asaj që u bë sot... Tani nuk fole drejt, xha Zylo.

ZYLOJA — Pse nuk fola drejt? Kështu është... Mua po më vdiste çupa ...

BESNIKU — Vetë e more më qafë.

ZYLOJA — Unë??

BESNIKU — Ti! Çfarë i dhe për të ngrënë?

ZYLOJA — Si çfarë i dhashë?

BESNIKU — Hë, de, çfarë?

ZYLOJA — (I zënë ngushtë.) Byreku apo ishte bërë dhe dy vezë të ziera ...

BESNIKU — Hasmi i sëmundjes! Jo vetëm që nuk tregove, po porosite Bardhën të hante e të mos bënte zë se çfarë i kishe sjellë. Ne vramë mendjen se nga

i erdhi gjithë ajo temperaturë dhe puçrat që i mbushën trupin.

ZYLOJA — (*I dëshpëruar.*) Si more?! Phuuu! Ç'paskam bërë! (*Ulet mbi një gur.*)

LUMTOJA — Ja kështu ndodh, kur nuk pyet...

ZYLOJA — (*Duke vështruar nga fshati.*) Plaka e Myrtos, moj... ajo... si të them... Jepi, more; çupës të hajë më tha, se, po të dëgjonim doktorët, do të kishim vdekur me kohë.

BESNIKU — Ku paske vajtur! Tek ajo që i ka dalë emri disa herë nëpër mbledhje e nëpër fletërrufera. (*I afrohet.*) Xha Zylo, mos i ke çuar vajzës fshehu-razi ndonjë muskë ...

ZYLOJA — (*Çohet në këmbë i zemëruar.*) More hak më duket ... Më rëndove.

BESNIKU — Si mund të mendosh se mora hak ndaj teje?

LUMTOJA — Xha Zylo!

BESNIKU — (*Sheh orën.*) Ne prapë do të bisedojmë ... Mua më falni, se më presin. (*Del.*)

LUMTOJA — Besnikun e rëndove si shumë.

ZYLOJA — Nuk e dëgjove si tha?

LUMTOJA — E dëgjova. Por ajo që tha ai është e vërtetë ...

ZYLO — Edhe ti!

LUMTOJA — Për ushqimin që i shpure Bardhës, umë i tregova Besnikut. Kjo gjë e ndihmoi pér punë të mjekimit, pasi ai dyshoi se mos i bënë reaksion ilaçet dhe po mendonte t'i ndërpriste ...

ZYLOJA — Ashtu, ë?!

LUMTOJA — Ja pse duhet të bëjmë ashtu si thotë mjeku, sepse ai i ka gjërat të bazuar në shkencë.

ZYLOJA — Domethënë unë e kam fajin! ... Kështu është. Koka bën, koka pëson. E hidhur është por është më se e vërtetë.

LUMTOJA — (*Qesh.*) I çuditshëm je, more xha Zylo.

Po të mos kishe këto të kërcyera hop-hop dhe që harron se çfarë thua, s'besoj ta gjenim një xha Zylo tjetër në botë.

ZYLOJA — Po xha Zylo ama!

LUMTOJA — (*Duke qeshur.*) E sigurisht vetëm xha Zylo.

ZËRI AGRONIT — (*Jashtë*) Drita, mbaje mirë.

ZËRI I DRITËS — (*Jashtë*) U lodha. Dale ca.

LUMTOJA — Drita, e morët televizorin? (*Hyn Drita.*)

DRITA — E morëm, moj Lumto, e morëm.

ZYLOJA — E gjëzofshi! ... O ç'do kënaqet Myrtoja tanë.

DRITA — E morëm, por ç'e do filluam të grindemi që në rrugë.

LUMTOJA — Pse?

DRITA — Po ja... Babai e do në dhomën e gjumit.

ZYLOJA — I shkreti, po si e more...

DRITA — Nëna e do në dhomën e prites që ta kemi përmiqjtë.

ZYLOJA — Hë! Jo!

LUMTOJA — Po ti?

DRITA — Unë dhe motra e duam në dhomën ku rrimë.

ZYLOJA — Kështu po ... E gjëzofshi.

LUMTOJA — Paskeni hyrë në telashe të mëdha.

ZYLOJA — Nga këto telashe paçim, pa i zgjidhim shpejt.

LUMTOJA — Do vi dhe unë sonte nga shtëpia.

DRITA — Mirë. (*Niset të dalë.*) U! Jo sonte. (*I flet Lumtos në vesh.*) Të pret Viktori.

LUMTOJA — Rri, de, tanë ...

DRITA — E pashë në stacion.

LUMTOJA — Pusho ... Bëra gabim unë që ta thashë...

ZYLOJA — Moj shejtanka, çfarë bisedoni ashtu vesh më vesh ... apo ...

DRITA — Jo ... po ...

ZYLOJA — Çfarë jo, po.

LUMTOJA — Ashtu kот, xha Zylo, si e ka Drita...

ZYLOJA — Drita! Fol ti, fol për mua, por kur të filloj
dhe unë pastaj.

DRITA — (E inatosur.) E çfarë do të thuash për mua?

ZYLOJA — Për atë bulldokun tënd!

DRITA — (Qesh.) Për mua e di gjithë bota...

ZYLOJA — Ka dhe ndonjë gjë që s'e di as ti dhe as bota.

DRITA, LUMTO — (Qeshin.) Hopa la! Xha Zyloja po
merret me thashetheme.

ZYLOJA — Moj çupani, po sa herë që flas unë, gjith-
një në gabim do të më kapni.

DRITA — Nuk është gjynah ta zesh në gojë për keq atë
bulldokun tim? (Qeshin).

ZYLOJA — Qeshni ju, qeshni.

DRITA — (Lumtos.) E po mirë atëherë, hajde të qajmë
pak se xha Zyloja nuk e dashka me të qeshur ...
Mor po ti puf të bësh, ne do të qeshim.

ZYLOJA — Edhe ti puf të bësh edhe unë do të qesh me
shumë se ti. (Qeshin të tre. Hyn Vera,) Hajde,
moj shoqja sekretare.

VERA — Hë, si është puna?

ZYLOJA — Po ja... Unë këtu, këto të dyja pësh-pësh në
vesh.

VERA — E po, vajza të reja, more xha Zylo.

DRITA, LUMTOJA — Hë?

ZYLOJA — Hm! Edhe ti u dhe të drejtë... Ika unë...

DRITA — Prit xha Zylo, do të vi dhe unë me ty,
se më pret televizori.

ZYLOJA — Televizori apo traktori?

DRITA — Të dy!

ZYLOJA — (Duke tundur kokën.) Po si thashë Myrtos.

DRITA — Edhe unë po s'i thashë nënë Meremes për ty.

LUMTOJA — Merru, merru me Dritën.

ZYLOJA — Ke tē drejtë. Nuk tē ngas mē ... Haj tē paj-tohem. (*Niset.*)

DRITA — Do tē vi dhe unë.

ZYLOJA — Me ty? Bah!

DRITA — Nuk tē ngas jo!

ZYLOJA — (*I tregon shkopin.*) Ja tek e kam. (*Dalin duke qeshur.*)

LUMTOJA — I mirë është shejtani, por e ka një ...

VERA — Ai ka një çikë tē drejtë, nē fund tē fundit moshë e kaluar është, po ç't'i bëjmë ndonjë si Viktori, ... Lumto!

LUMTOJA — Urdhëro!

VERA — Viktori nuk erdhi akoma?

LUMTOJA — Përse ma thua mua këtë?

VERA — Po ja ... sepse ti ... Mua s'më ke treguar gjë.
Nejse ...

LUMTOJA — Drita ta tha?

VERA — Jo, vetë ti.

LUMTOJA — Unë?

VERA — Po, ti.

LUMTOJA — Kur?!

VERA — Edhe tani që po bisedojmë ... Tē tradhtojnë sytë. (*Qeshin.*) Megjithëse dhe Drita më tha diçka. Dëgjo, Lumto, ti duhet ta ndihmosh.

LUMTOJA — Ti, nuk e di sa kam luftuar unë me tē. Kjo është një histori e gjatë. Kur e caktuan tē punonte nē fshat, pér këtu kërkoi vetë, sepse isha unë ...

VERA — E di.

LUMTOJA — Ti po më habit me këto e di.

VERA — Para ca ditësh isha nē qytet pér ca punë nē komitetin e partisë. Atje takova Viktorin dhe bisedova gjerë e gjatë me tē, bile dhe pér çështje intime ... Ai m'u hap ... Po ti ke bërë mirë që nuk

je tħyier para mendimeve tē tij, bile i ke thënne se īku tē ċojnë ato ... Megjithatē ai tē do ...

LUMTOJA — Shoqja Vera, rri e pyes veten shpesh, pēr-se t'i ketē ai kēto mendime. Mē vjen tē pēlcas, kur Viktori, bir prindērish qē nuk i janē trembur as vdekjes, ma sheh fshatin si ndonjē borgjez.

VERA — Lumto, jo kaq rēndē!

LUMTOJA — Dyert e fshatit kanē qenē tē hapura si pēr prindērit tanē għajnej Lufts, ashtu dhe sot pēr ne, pēr bijtē e tyre. (*Hyn Viktori me njē ċantē, i vrat ħarrar shpirtērisht. Vera i ka kħthyer shpinēn, Lumtoja nuk e vē re*). Kētē kam tē drejtē ta them me zē tē lartē, sepse jetoj nē mes tē tyre... Unē e dua Viktorin, shoqja Vera, ... por ai eshté i ledhatuar jashtē mase, prandaj dhe ia luftoj konceptet qē ka, (*Sheh Viktorin, shqetēsohet.*) Mē fal, Vera. (*Del me vrap.*)

VERA — Lumto! (*Kthehet nga Viktori.*) Erdhe? A Viktor, Viktor, na ke shqetēsuar tē gjithi.

VIKTORI — (*Mezi gjen fjalēt.*) Shoqja Vera, nuk mendova... se konceptet e gabuara do mē shpinin nē veprime tē gabuara... Mē besoni, unē nuk kam sy e faqe tē dal pērpara njerēzve... Rruga qē nga stacjoni e deri kētu m'u duk ...

VERA — Hiqi ato mendime mgħa koka, Viktor ... Kolektivi tē pret, tē tērē duan tē tē kenē nē mes tē tyre ... Asnjéherē mos kujto se tē shikon njeri shtrembér.

VIKTORI — Ashtu mund tē jetē, (*Sheh nē drejtimin nga doli Lumtoja*) por...

VERA — Shko, shko bisedo me tē ... Ajo eshtē njē mgħa vullnetaret e para qē erdhi kētu nē fshatin tomē. Ajo tē do po aq sa ċ'e do dhe ti, vetēm se duhet tē dish se ka dhe njē dashuri mē tē madhe, dashuria pēr punēn, pēr njerēxit, pēr fshatin koope-

rativist, për jetën tonë të re ... Këtë duhet ta kuptosh drejt.

VIKTORI — E kuptoj, shoqja Vera.

VERA — Kjo dashuri, Viktor, e rrit dhe e forcon më tepër dashurinë e familjeve tona, pra edhe të familjes së re që ju doni të krijoni...

VIKTORI — Të falem nderit, shoqja Vera!

VERA — Unë nuk dua të bëhem ndërmjetëse, por do të të them vetëm një gjë: shko bisedo me të, ... arsyetoni bashkë dhe vendosni. Vetëm se mos përdor autoritetin prej burri...

VIKTORI — Ju falem nderit! (*Niset, po qëndron përrpara stendës së fletërrufesë*).

VERA — Lexoje, lexoje. Është për ty. (*Hyn Artani me vrap me gazeta ndër duar.*)

ARTANI — Shoqja Vera, ja dhe gazetat i solla. Kam një lajm, të gëzuar.

VERA — Çfarë lajmi, mor Artan?

ARTANI — Në gazetë ka një artikull ku flitet për doktor Besnikun, për Lumton, për ... (*Sheh Viktorin.*) Oh! Mirë se erdhe, Viktor! (*I jep dorën.*) Erdhe?

VIKTORI — Erdha.

ARTANI — Përgjithmonë.

VIKTORI — Po, Artan. (*Artani i bie në krahë.*)

ARTANI — Të lumtë! Oh! Më fal, të leva me gëlqere.

VIKTORI — Bojaxhi qënke bërë?

ARTANI — Lyem pemët ... Ja, shikoji.

VIKTORI — I pashë ... Veçse unë u vonova...

ARTANI — Këtë radhë po... Mos u mërzit se aksionet përpëra i kemi.

VERA — Drejt e the, Artan.

ARTANI — Ika unë të shpërndaj, gazetat. (*Niset.*)

VERA — Dëgjoni se ç'shkruan artikulli. (*Artani ndalat.*) Vullnetarët e parë, duke përqafuar dhe duke

konkretizuar fjalët e partisë, që fshatin ta bëjmë si qyteti, kanë punuar e po punojnë me një shembull të lartë e me hov revolucionar, duke mos kursyer forcat e tyre. Në ballë të kësaj lufte qëndrojnë mjeku Besnik Shkoza, Lumto Shkëmbi Ar-tan Lera e të tjera nga të cilët duhet të marrin shembull që të gjithë ...»

P A R A S K E N E

Rrugë fshati. Kalon Lumtoja me çantë në dorë.

DRITA — (Nga jashtë) Lumto ... Lumto moj ... Për ku kështu?

LUMTOJA — E po, nuk do rrahur kjo? Bërtet sikur jam kushedi se ku... (Hyn Drita.)

DRITA — Lumto moj, dëgjon apo jo?

LUMTOJA — Veshët në vend i kam, prandaj mos bërtit kaq shumë ... Ja ku më ke.

DRITA — Lumto!

LUMTOJA — Plaç de!

DRITA — Pse nuk përgjigjesh.

LUMTOJA — E marr vesh unë ku e ke hallin ti, po ...

DRITA — Jo, për kokën tënde asnje hall nuk kam.

LUMTOJA — Thuaj për kokën e bulldokut!

DRITA — Atë mos ma zer në gojë ... Dëgjo. Sa thirra unë Lumto, ai e nxori kokën menjëherë në dritare, sikur të priste prapa derës...

LUMTOJA — E mirë, mirë ...

DRITA — Mos më thuaj mirë, se që kur ka ardhur Vïktori këtu, ti ke ndërruar dhe rrugën për të shkuar në shkollë. I bie gjoja për më shkurt këndej nga spitali ... Por mua s'ma hedh dot.

LUMTOJA — Prapë fillove ti?

DRITA — Dëgjo. E kapa Viktorin dhe i folat...

LUMTOJA — Për çfarë?

DRITA — Për ty ... Që ti e do.

LUMTOJA — Je në vete?

DRITA — E di si më tha? Nuk jam mirë me të.

LUMTOJA — Me kë?

DRITA — Me ty, de... Për kokën tënde, kështu më tha...
Për kokën e bulldokut...

LUMTOJA — (*Kurioze.*) Po pastaj?

DRITA — Unë nuk e meritoj ngrrohtësinë që tregojnë
fshatarët për mua ... dhe shkulte barin me dorë...
(*Hyn Artani me një lopatë mbi sup.*)

ARTANI — Haber!

DRITA — Çfarë haberi, mor Artan!

ARTANI — Do të na vijë nga qyteti një aparat radio-
skopie për të parë mushkëritë dhe stomakun.

LUMTOJA — Nga e more vesh ti?

ARTANI — Kryesia bëri mbledhje ... Ngjitur me spitalin
do të shtohen dhe 3 dhoma të tjera për aparatin.
Puna do të fillojë menjëherë, me goditje të për-
qëndruar.

LUMTOJA — Kaq shpejt??

ARTANI — Ja shikoni, po fillon piketimi, erdhi gjeo-
metri. (*Hyn Vera.*)

VERA — Çfarë po shikoni ashtu?

LUMTOJA — A është e vërtetë?

VERA — E paskeni marrë vesh? ... Është më se e
vërtetë. Do të fillojmë menjëherë nga puma. Nga
qyteti do të na ndihmojnë me materiale, ne do të
punojmë me forcat tona ... Lumto, po ti me nxë-
nësit a mund të na ndihmosh, po pa penguar më-
simet.

LUMTOJA — Patjetër.

VERA — Mirë, Lumto ... (*Hyn Viktori me bluzë të bar-dhë, i sheh dhe përpinqet të ndërrojë rrugë*). Ja dhe Viktori... Hajde, Viktor, hajde, përsë deshe të ktheje rrugë?

VIKTORI — Thashë se mos kishit punë.

VERA — Për spitalin po bisedojmë.

VIKTORI — E mora vesh ... Isha dhe unë në mbledhje së bashku me ju, por prapë më duket si një gjë e pabesueshme.

ARTANI — Filloi piketimi, Viktor.

VIKTORI — E shoh, Artan, e shoh!

VERA — Tani e ka fjalën puna shkencore, gjë për të cilën ti ke pasë shumë merak në fillim.

VIKTORI — Kjo është e vërtetë!

VERA — Atëherë le t'ia fillojmë ... (*Lumtos.*) Bashkë do të takohemi përsëri.

DRITA — Kështu, Lumto! (*Ja bën Lumtos me kokë për nga Viktori.*)

VERA — Lere, moj, rehat. (*Dalin Vera, Drita, Artani*)

VIKTORI — Lumto! Ku po shkon?

LUMTOJA — Në shkollë.

VIKTORI — A mund të të shoqëroj! ... Dua të bisedoj me ty.

LUMTOJA — Mirë. (*Nisen.*)

(*Dëgjohet një zhurmë makine që frenon. Hyn Vera përsëri.*)

VIKTORI — Pse e futi gazin nëpër ara?

VERA — Prit!

LUMTOJA — Qëndroi!

VERA — (*Thërrët*) Ç'ka ndodhur?
(*Hyn Qemali duke vrapiuar*)

QEMALI — Shoqja Vera ... Gruaja e Rexhepit është pa ndjenja. Nuk e lëvizin dot... Erdha të marrë doktor Besnikun.

VERA — Ai s'është këtu.
VIKTORI — Po shkoj unë ...
LUMTOJA — Ik, Viktor.
QEMALI — Nisemi. (*Dalin.*)

LUMTOJA — (*Buzëgaesh*) Kështu të dua dhe më shumë

LUMTOJA — (*Buzēqesh.*) Kēshtu tē dua dhe mē shumē.

AKTI I TRETE

Në anën e majtë duket hyrja e spitalit të kooperativës. Një dritare bie nga salla. Në anën e djathtë një — dy pemë, nën të një stol i gjatë. Në sfond panorama e fshatit, fusha të mbjella, kodra me tarraça, shtëpi të grumbulluara; në thellësi male. Përpara derës së spitalit 2-3 shkallë. Sapo hapet perdja, jepet përshtypja se po ndërtohet diçka jash-të skenës. Hyn Islami me një dërrasë në dorë. Zana në dritare fshin xamat.

ISLAMI — Hë, more djema, lëvizni ... më shpejt.

ARTANI — (Me dërrasë në dorë) Erdhëm, xha Islam.

ISLAMI — Edhe ju të tjerët. (Atmosferë pune vullnëtare, kalojnë nëpër skenë Qemali, kuzhinierja, Drita, me kazma, dërrasa etj. Lumtoja i afrohet Zanës).

LUMTOJA — Aty është?

ZANA — Këtu. (Buzëqeshin. Hyn Islami.)

ISLAMI — (Lumtos.) Nuk ma mori mendja se Viktori do t'i qëndronte mbi kokë të sëmurës.

ZANA — Vetëm një gjë mund t'ju them ... U bënë kaq net që ai po gdhihet mbi kokën e të sëmurës.

ISLAMI — Si u bë sot?

ZANA — Vazhdon të jetë rëndë... Ai e ka marrë përsipër ta shërojë dhe nuk ka lëvizur fare nga e sëmura ... (*Lumtos.*) Të kujtohet, Lumto? Në fillim Viktori nuk donte t'i mbante të sëmurët që kishin vështirësi për t'i shëruar.

LUMTOJA — Me kë rri, ashtu do të bëhesh.

ISLAMI — Si the, moj bijë?

LUMTOJA — E kisha fjalën për Besnikum, për Zanën ... I ka pranë në çdo hap. (*Hyn Drita.*) Kjo më gëzon pa masë.

ISLAMI — Edhe unë, moj bijë, më beson, e dua si djalin tim.

DRITA — Jo më shumë se Lumtoja, xha Islam.

ISLAMI — A shejtane ti!

DRITA — Asnjeri nga ne nuk do që ta ketë Viktorin, qoftë dhe një hap larg nga vetja jonë. Prandaj Lumtoja (*Imiton Lumton.*) ka të drejtë kur thotë se gëzohet pa masë.

ISLAMI — (*Kureshtar.*) Si është kjo puna e të gëzuarit pa masë?

DRITA — Është si puna e atyre viçave, që të lindin ty lopët më stallë dhe që ti s'e përmban dot · veten nga gëzimi. Si ta them ...

LUMTOJA — Hiç mos e thuaj ... A e di ti, xha Islam, se kjo kohët e fundit ka filluar të merret me thashetheme?

ISLAMI — Atëherë duhet të të vëmë ty një fletërrufe, që nuk ia ke vënë më dukje. (*Qeshin.*)

ZËRI ZYLOS — (*Nga jashtë.*) Gurë, Lumto!

LUMTOJA — Erdha! E lëmë me kaq se muhabeti nuk merr fund ... Po na thërrasin. (*Del.*)

ISLAMI — Na, moj ti, shejtane, kemi ndonjë lajm kështu?

DRITA — Do tē ta trègoj kur tē bie llokumet. (*Ikën.*)
ISLAMI — Na, moj ... E po, nuk tē vjen tē pëlcasësh ...

(*Me vete*) Mor po do ta marr vesh unë se s'bën.
(*Viktori hap derën e spitalit, qëndron pér një çast, hap krahët. Duket i lodhur e pa gjumë, por dhe i gëzuar.*) Hë, doktor!

VIKTORI — Xha Islam, më ler tē tē përqafoj ...

ISLAMI — Si është puna!

VIKTORI — (Zbret shkallët, bën 2-3 hapa dhe ndalet.)
Shpëtoi!

ISLAMI — Vërtet?

VIKTORI — Jam më se i sigurt.

ISLAMI — Atëherë më ler ti mua tē tē përqafoj. (*Përqafohen.*)

VIKTORI — Të falem underit!

ISLAMI — Ne duhet tē tē falënderojmë.

VIKTORI — Jo, xha Islam. Kur tē thashë tē faleminderit e kisha fjalën pér diçka edhe më tē madhe ... Më duket sikur po gjej vetveten, ashtu siç më kanë folur prindërit, shokët, Besniku, Zana, Lumtoja ... A e di? Vera më erdhi deri në shtëpi ... Edhe ti, xha Islam, pér ato që pe tek unë m'i the copë, pa asnje zbukurim ... Prandaj tē thashë tē falemnderit.

ISLAMI — Edhe unë tē them me plot gojën se përpara meje kam një mjek, bir tē fshatit tonë.

VIKTORI — Të falemnderit, xha Islam! (*Kërkon pagetën e cigares.*) Ndize, xha Islam.

ISLAMI — (*Merr një cigare dhe nxjerr kutinë e duhanit.*) Ndize një tē dredhur ... Është duhan fshati ... Po ulu se je dhe i lodhur. (*Viktori ulet në stol. Islami i ndez cigaren.*)

VIKTORI — Ulu, xha Islam! (*Islami ulet. Pauzë e shkurtër.*) Do tē më thuash tē vërtetën?

ISLAMI — Urdhëro, bir!

VIKTORI — Ashtu si të njohim të gjithë të singertë e që i thua gjërat troç.

ISLAMI — Fol!

VIKTORI — Netë të tëra kam ndenjur pa gjumë dhe më në fund ia dhashë përgjigjen.

ISLAMI — Kujt?

VIKTORI — Vvetes! Nuk kisha asnjë të drejtë ... Por ju të gjithë m'u gjendët pranë e më thatë bëj kështu dhe nuk m'u shkulët që nuk m'u shkulët... I nisa dhe një letër një shokut tim që ka zënë një qoshe të rehatshme diku në qytet... Më vjen turp kur e kujtoj që bridhja nëpër korridoret e komitetit për të gjetur ndonjë «mik»... Kështu i shkruratja shokut, këtë ia thashë dhe vetes.

ISLAMI — Hajde, bir i xha Islamit, hajde ... Paske bërë një punë shumë të mirë... edhe për shokun... shkruaji, takoje dhe tregoja të vërtetën, ashtu siç është, pa ndonjë zbukurim.

ZËRI ARTANIT — (*Nga jashtë*) Xha Islam!

ISLAMI — Erdha! E dëgjon? Më thërrasin shokët ...
(*Tek dera e spitalit del Besniku dhe i vështron.*)

VIKTORI — Shkojmë bashkë.

BESNIKU — Jo, Viktor... Ti je shumë i lodhur... Duhet të qetësohesh

VIKTORI — As që e ndiej lodhjen fare.

BESNIKU — (*Zbret shkallët.*) Ka të drejtë, xha Islam. Viktorit i duket sikur në këtë çast po fluturon.

ISLAMI — E mora vesh edhe pa ma thënë... (*Viktorit*)
Mos ki merak ti, se hisen tënde të punës do të ta lëmë më një anë... Me gjithëse ty të bie të punosh më shumë se të tjerët, se na hëngre të gjallë me atë shqencën tënde... Ja dhe shqenca po rritet.

ZËRA NGA JASHTË — Xha Islam!

ISLAMI — Ika!... Do punë shqenca. Do apo nuk do!

VIKTORI — Do dhe shumë bile... (*Qeshin, Islami del.*)

BESNIKU — E si mund të rrish larg këtyre njerëzve të mrekullueshmë larg kësaj çiltërsie kaq të madhe. (*Dëgjohet zhurmë pune. Zëra që thërrasin: hooo-hooop!*) Shiko si punojnë!

Viktori — Besnik, kam vënë re se ti je ca romantik ose si mund ta them ndryshe... S'më vjen të besoj se ke këtu në kooperativë 3 vjet, po më duket sikur je rritur bashkë me ta. Për këtë lloj romantike e kam fjalën...

BESNIKU — Është vrulli i kohës që po kalojmë, Viktor... Ku të lënë këta njerëz të mbyllësh brenda katër mureve të spitalit, larg jetës, larg njerëzve...

VIKTORI — Atëherë, mirupafshim! (*Heq bluzën e bardhë.*)

BESNIKU — Jo, Viktor, nuk e kisha fjalën për ty... (*Del Zana tek dera e spitalit.*)

VIKTORI — As unë nuk e mora për vete, por siç e tha dhe xha Islami: shqenca do punë. (*Del. Dëgjohen zëra: hooo-hooop! kape Viktor.*)

BESNIKU — E, Viktor, Viktor! Kjo të bën mirë.

ZANA — Ajo i bën mirë me të vërtetë. (*Zbret nga shkallët.*)

(*Hyn Islami, Drita, Viktori.*)

ISLAMI — O burrani! Lëvizni duart.

DRITA — Thuaj, o gra, në fillim, pastaj, o burra.

ISLAMI — A, ti shejtane!

BESNIKU — Ti, Viktor, duhet të pushosh.

VIKTORI — A, tani jam nën urdhërat e xha Islamit.

BESNIKU — Këtu ke të drejtë!

VIKTORI — (Zanës.) Po të kesh ndonjë nevojë për të sëmurët më thirr se këtu jam.

ZANA — Mirë. (*Me shaka.*) Kujdes se mos ftohesh! (*Viktori del.*)

ISLAMI — Vetëm nga puna nuk tē gjen gjë! (*Hyjnë në skenë me një dërrasë Drita me Viktorin.*)

DRITA — Mbaje, Viktor.

VIKTORI — Hopa! (*Hyn Lumtoja. Drita ia le dërrasën vetëm Viktorit dhe shkon tek Lumtoja.*)

LUMTOJA — Jo vetëm se është e rëndë!

DRITA — (*Lumtos*) Hë de, çfarë pret? Kape!

VIKTORI — (*Dritës*) Pse e le?

DRITA — Ku janë dy veta, i treti është i tepërt. (*E qëllon Viktorin miqësisht në faqe dhe del me vrap.*)

VIKTORI — A shejtane ti, shejtane. (*Lumtoja qesh.*)
Pse qesh?

LUMTOJA — Po ti pse qesh?

VIKTORI — Kush?

LUMTOJA — Ti.

VIKTORI — Sepse tē pashë ty që po qesh.

LUMTOJA — Unë nga ty qesha. (*Bën me dorë shenjën e dackës që i dha Drita.*)

VIKTORI — Unë kam tē drejtë tē qesh... Sot jam i lumtur.

LUMTOJA — (*Me thumb*). Prandaj e ngrite dërrasën?

VIKTORI — Unë mund tē tē ngre dhe ty!

LUMTOJA — Mua?

VIKTORI — Po, ty!

LUMTOJA — Pa provoje. (*Viktori përpinqet ta kapë, ajo i shpëton nga dora.*)

VIKTORI — Pse u largove?

LUMTOJA — Për arsyen se e di që e bën me gjithë mend.

VIKTORI — Tani e beson?

LUMTOJA — Shkojmë se po na presin... (*Niset*)

VIKTORI — Lumto!

LUMTOJA — (*Ndalet*) Fol!

VIKTORI — Lumto, kanë kaluar kaq muaj dhe ti....

LUMTOJA — Çfarë unë?

VIKTORI — Po ja... ti

LUMTOJA — Ndoshta tē duket...

VIKTORI — Vërtet? Nuk po ma bën qejfin.

LUMTOJA — Ti më njeh mirë, Viktor... Ne kemi kohë që njihem bashkë... Pse më shikon ashtu?

VIKTORI — Dhe sa shumë jemi grindur.

LUMTOJA — Asnjëherë për keq.

VIKTORI — Kjo është e vërtetë.

LUMTOJA — Tjetër çfarë deshe tē më thuash? (*Hyn Drita, i shikon tē dy që bisedojnë, fshihet pas stolit.*)

VIKTORI — Lumto, unë...

DRITA — Hë de, thuaje tē shkretën. (*Fshihet përsëri.*)

VIKTORI — Kush foli.

LUMTOJA — Edhe mua ashtu m'u duk.

VIKTORI — Na kanë bërë veshët... (*Qeshin.*)

LUMTOJA — Shkojmë se ma presin.

VIKTORI — Prit... dua tē tē them diçka... ti e di që unë ... tē dua.

DRITA — (*Që prapa stolit.*) Ika unë tē marr llokumet. (*Del me vrap.*)

VIKTORI — Çfarë llokumesh?

LUMTOJA — M'u duk si zëri i Dritës.

VIKTORI — Të kanë bërë veshët ndoshta... (*Hyn Drita me Zylon dhe tregon me gisht Lumton e Viktorin.*) Lumto, tē thashë se...

LUMTOJA — Po, Viktor, ne kemi kohë që duhem.

VIKTORI — Lumto!

ZYLOJA — (*Do tē flasë, por Drita i mbyll gojën me dorë, pastaj ia liron.*) Hopa-la! Plasi këtu...

(*Hyjnë në skenë tē gjithë: Islami, Besniku, Qemali, kuzhinierja. Atmosferë gazmore.*)

ISLAMI — Çfarë ka ngjarë?

VIKTORI — (*Ngatërron fjalën.*) Ne u martuam. (*Tē gjithë qeshin.*)

LUMTOJA — Viktor, çfarë thua kështu?

VIKTORI — Pse çfarë thashë?

ZYLOJA — (*Duke qeshur.*) The se u martuat.

VIKTORI — Unë?

TË GJITHË — TI.

VIKTORI — Jo... po... ne duhem.

KUZHINIERJA — Duhuni, të keqen nëna, duhuni ... Kuzhinën jua pregatis unë si s'ka më mirë.

VIKTORI — Po dhe do të martohemi... Bile shpejt. Apo jo, Lumto?

LUMTOJA — Uaaa! Viktor! Çfarë na bëre kështu?

TË GJITHË — Të trashëgoheni. (*Hyn Drita me një kuti me llokume.*)

DRITA — Prisni! Nuk urohet kështu thotë. Merrni me radhë llokumen dhe urojeni çiftin. (*Bie zilja e telefonit. Zana del në dritare me telefon në dorë.*)

ZANA — Doktor Besniku!

DRITA — Sht! Pushoni!

ZANA — Doktor Besniku, ju kërkojnë në telefon...

BESNIKU — (*Merr receptorin.*) Po ... Besniku jam... Ah!

Ju jeni. Mos u bëni merak ... Viktori është shëndosh e mirë si molla. (*Drita fyrn faqet dhe tregon me duar.*) Ai sot ka korruj suksesin e parë tek ne: shëroi një shoqe, që qe mjaft sëmurë... Në këto caste ai është më i gjëzuar midis nesh.

DRITA — Thuaji se është çiftosur. (*Viktori me Lumton bisedojnë.*)

BESNIKU — Le t'ia thotë vetë... Jo, nuk e kisha me ju, Viktor! O Viktor! (*Ai vazhdon të bisedojë me Lumton.*)

DRITA — (*Qesh*) O, Viktor!

ZANA — E ka humbur fare.

ZYLOJA — Viktor, të kërkojnë në telefon.

VIKTORI — Kush më kërkon? *(të dojv. përmend - ZYLOJA)*
BESNIKU — Prindërit. *(mëndësuar mësuar si një - ZYLOJA)*

VIKTORI — (*Në telefon*) Ti je, mama! Po, mama, shpëtoi. Pranë m'u gjendën që të gjithë, Besniku, Zana... S'di kë të përmend më parë... Nuk di çfarë të them pér këta njerëz, janë që të gjithë të mrekullueshëm... Së shpejti na vjen dhe aparati i radio-skopisë dhe do të filloj menjëherë nga puna shkencore... Po... po, sigurisht, Si? Pse s'kam ardhur?..., Ke të drejtë, por nuk më ka lënë puna, moj mama, kemi aq shumë punë sa... *(në qyt. përmend - ZYLOJA)*

ZANA — (*I merr receptorin nga dora*.) Jan dhjetë fshatra që presin ndihmë nga ne. *(në qyt. përmend - ZYLOJA)*

VIKTORI — (*I merr receptorin*.) E dëgjove?... Si? Babai? Nëma. Fol, baba, po të dëgjoj... Vërtet? Thuhje dhe një herë?... Urraaa! *(në qyt. përmend - ZYLOJA)*

BESNIKU — Si është puna? *(në qyt. përmend - ZYLOJA)*

VIKTORI — E dëgjuat? *(në qyt. përmend - ZYLOJA)*

ZYLOJA — Vetëm urraaa dëgjuam! (*Hyn Vera me nxitim*.) Po hajde, moj shoqja sekretare. Ç'u bëre?

VERA — Isha në fushë, xha Zylo... Organizova forcat që do të na vijnë në ndihmë. *(në qyt. përmend - ZYLOJA)*

ZYLOJA — Ata mirë se të vijnë, punë ka pér të gjithë... Por këtu më duket se plasi... Iku ky (*Tregon Viktorin*)... *(në qyt. përmend - ZYLOJA)*

VIKTORI — Sht! Si me shtëpinë?... Kur?

VERA — Ta marrim vesh një herë si është puna? (*I afrohet Viktorit*) *(në qyt. përmend - ZYLOJA)*

VIKTORI — E kuptova... Na fol këtu. (*I jep Verës receptorin në dorë*). *(në qyt. përmend - ZYLOJA)*

VERA — (*Në telefon*.) Dëgjoj... dëgjoj... Jam Vera ... Po ... I gjeta shumë të gëzuar, ... por nuk më treguan gjë... Me lanë telefonin në dorë.., Si? Babai i Viktorit,, Ju kuptova... Mirë se të vini.

DRITA — Lumto, vjehrri! (*Qeshin.*)

VERA — Ne ju presim krahëhapur... Paska të drejtë Viktori që është shumë i gjëzuar. (*I jep telefonin Viktorit.*)

VIKTORI — Baba, ma thuaj ditën dhe orën kur do të vimi, se do të dalim bashkë me nusen t'ju presim... Pô, po me nusen ... Lumto, eja këtu.

DRITA — Hajde t'i flasësh vetë. (*E têrheq për krahu.*)

LUMTOJA — Më vjen zor.

VIKTORI — (*I afron receptorin tek veshi.*) Foli!

LUMTOJA — Mirë ardhçi! (*Qeshin të gjithë.*)

VIKTORI — (*Në telefon.*) Ishte nusja ajo që foli ... Pse foli kaq pak?... Në fillim nuset flasin pa... E turpshme, the? ... Ah! Sa e turpshme është kjo! Umë e di, që e provova vetë... Ju presim ... (*I jep telefonin Zanës.*)

ISLAMI — Si është puna, moj shoqja sekretare?

VERA — Prindërit e Viktorit vijnë përgjithmonë më fshat.

ISLAMI — Edhe ne i presim krahëhapur.

TË GJITHË — Mirë se të vijnë.

VIKTORI — Ju falem nderit... ju falem nderit të gjithë... Ju jeni me të vërtetë të mrekullueshm. Ju m'u gjendët kaq pranë... Unë nuk di të flas bukur ... por vetëm një gjë do t'ju them se së bashku me Lumton nuk do të ndahemi asnjëherë nga ju... Apo jo, Lumto?

LUMTOJA — Po, Viktor!

Fund

Tirazhi 1.000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1977